

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-157/2014**

**Prishtinë,  
14 Prill 2016**

Në çështjen juridike të:

**S. D.**

*Pala ankuese*

Kundër.

**K. R.**

*Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, si kryetar i kolegjit, gjyqtarët Anna Bednarek dhe Beshir Islami anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/191/2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA31711), të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 Prill 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga S. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/191/2013, e datës 12 shkurt 2013, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/191/2013, i datës 12 shkurt 2013, vërtetohet në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA31711.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 7 mars 2007, S. D.(tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar ri-posedimin e (banesës me sipërfaqe të përgjithshme prej 70,48m<sup>2</sup> me lokacion në katin e parë në ndërtesën e ndërtuar në ish rrugën “Vidovdanska” në Klinë, në ngastrën nr. 585 (tani e tutje: pronë e kërkuar). Ai ka shënuar 18 qershorin 1999 si datën e humbjes së pronës. Pala ankuese ka sqaruar se ai ishte pronari i banesës, të cilën e kishte blerë përsëri në vitin 1998, edhe pse nuk e posedon kontratën, e as nuk ka mundur ta sigurojë një kopje të saj nga Gjykata Komunale në Leskovc. Pasi pronë e kërkuar ka qenë duke u shfrytëzuar nga K. R. pa pajtimin e tij, pala ankuese ka kërkuar kompensim.
2. Bashkë me kërkesën e tij, pala ankuese ka paraqitur në AKP kopjen e vendimit mbi ndarjen e banesës (02.Nr.360-2 të lëshuar në Klinë më 7 dhjetor 1998). Vetë pala ankuese e ka nënshkruar këtë vendim në emër të Komisionit Komunal për Ndarjen e Banesave nga Fondi i Solidaritetit dhe Mjetet Buxhetore. Rrjedhimisht ai po ashtu ka dorëzuar kontratën mbi shitblerjen e banesës të datës 30 dhjetor 1998. AKP-ja i ka verifikuar negativisht të dy dokumentet.
3. Lënda është regjistruar me numër KPA31711.
4. Më 11 qershor 2007 është bërë njoftimi i kërkesës. Sipas raportit të verifikimit pronë e kërkuar është gjetur se ishte banesë. Në kohën e vizitës objekti është gjetur e zaptuar nga K.R., i cili ishte i pranishëm në pronë, me ç ‘rast ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje dhe ka deklaruar se nuk kërkon të drejtën pronësore mbi këtë pronë. ‘

5. Më 8 tetor 2012 pala ankuese ka paraqitur në AKP kopjen e vendimit 344/99 të lëshuar më 18 tetor 1999 nga Komuna e Klinës.
6. E drejta e shfrytëzimit të pronës së kërkuar e palës përgjegjëse në ankesë është njohur duke u bazuar në nevojat humanitare.
7. Më 13 shkurt 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/R/191/2013 (tani e tutje: vendimi i KKPK-së) ka hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 9, 27, 28 dhe 65), KKPK-ja nënvizoi se pala ankuese nuk ka arritur të tregojë se kërkesa e tij përfshin rrethana që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose që janë pasojë e konfliktit të viteve 1998-99, si dhe të tregojë se ishte në posedim të banesës.
8. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 24 mars 2014. Më 30 maj 2014 pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Më 16 prill 2014 the pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.
9. Vendimi i njëjtë i është dorëzuar K. R. më 14 janar 2014.

### **Pretendimet e palëve**

10. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës ta “anulojë vendimin dhe ta urdhërojë KKPK-në të lëshojë një vendim që i njeh atij të drejtën pronësore mbi banesën”. Në ankesë ai tregon se vendimi i KKPK-së mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe përmban edhe shkelje serioze të ligjit material dhe procedural. Sipas mendimit të palës ankuese, si pikënisje shkelja e ligjit është manifestuar me mosnjohjen e të drejtës së tij pronësore mbi banesën. Ai po ashtu vë në pyetje edhe arsyetimin e komisionit i cili ka pohuar se pala ankuese nuk e ka dëshmuar se a humbur posedimin për shkak të rrethanave të konfliktit. Pala ankuese ka treguar se në vitin 1999 ishte refugjat, dhe se nuk i lejohej të kishte ndonjë pronë në posedim.
11. Më 12 shtator 2014 K. R. paraqiti një përgjigje të panënshkruar ndaj ankesës.

### **Arsyetimi ligjor**

12. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se vendimi i apeluar i KKPK-së është i plotë dhe gjendja faktike e tij është vërtetuar drejt dhe mbi këtë bazë si ligji material ashtu edhe ai procedural janë zbatuar drejt. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.

13. Pala ankuese pretendon se ka fituar të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar në pajtim me ligjin. Dokumentet që i ka paraqitur nuk e vërtetojnë këtë rrethanë. Gjykata Supreme pohon se KKPK-ja ka shqyrtuar dhe vlerësuar drejt provat.
14. Në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, *“Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar dhe, përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t’i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:*
- (a) *Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtsbëm private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe*
- (b) *Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtsbme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,*
- Ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore”.*
15. Sipas mendimit të gjykatës, asnjëri nga dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese nuk vërteton se pala ankuese posedonte pronën e kërkuar para ose gjatë konfliktit. Siç ka vërtetuar AKP-ja, pala ankuese në mbështetje të kërkesës së tij ka dorëzuar vendimin mbi ndarjen dhe kontratën e shitblerjes, por asnjëra nga to nuk është vërtetuar pozitivisht. Përveç kësaj, vetë pala ankuese e ka nënshkruar këtë vendim në cilësi të Kryesuesit të Komisionit Komunal për Ndarjen e Banesave i Komunës së Klinës. Prej dokumentacionit që pala ankuese ka dorëzuar megjithatë (p.sh. kontrata mbi ndërtimin) duket se prona e kërkuar ishte në ndërtim e sipër gjatë konfliktit. Për më shumë, gjatë bisedës telefonike me përfaqësuesin e AKP-së pala ankuese kishte deklaruar se kurrë nuk kishte jetuar në pronën e kërkuar, pasi ende nuk ishte e përfunduar pra konfliktit më 1998 dhe madje as nuk ishte i zhvendosur nga Kosova.
16. Mandati i AKP-së është të shqyrtohen lëndët “që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999”. Kjo do të thotë se fushëveprimi i ekzaminimit të AKP-së është verifikimi i këtyre elementeve: kush ishte në posedim të pronës së kërkuar para 27 shkurtit 1998, kush është në posedim të saj tani, kur dhe për çfarë arsye është humbur posedimi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Formulimi i nenit 3.1 *“të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti*

*janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur”* nënkupton lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të humbjes së posedimit dhe konfliktit të armatosur ose lidhjen e ngushtë të shkakut dhe pasojës e cila në lëndën konkrete mungon. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme në shkresa të lëndës ka mjaft elemente që tregojnë se banesa si e tillë nuk ishte e përfunduar ende në momentin e ndodhjes së konfliktit. Për këtë arsye konstatimi i palës ankuese sa i përket posedimit të pronës së kërkuar para ose gjatë konfliktit duhet të konsiderohet se është në mospërputhje me realitetin.

17.Kjo e bën Gjykatën Supreme të arrijë në përfundim se çështja e kërkesës bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe ankesa e palës ankuese të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i apeluar i KKPK-së të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar le Ligjin nr. 03/L-079.

#### *Konstatim*

18.Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195, paragrafit 1(d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

19.Ky aktgjykim nuk paragjykon të drejtën e palës ankuese për ta drejtuar lëndën e tij në gjykatën kompetente jashtë juridiksionit të paraparë me dispozitat e nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

#### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit**

**Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it**

**Beshir Islami, gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it**